



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-7600/2023

Klinë, dt:09.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare nr.28, më datën 04.06.2008, dispozitat e nenit 8 të Rregullore së MF-së nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-123/2010 të datës 04.04.2010 si dhe duke marrë parasysh Thirrjen publike për financim të OJQ-ve të datës 13.02.2023, Kryetari i Komunës së Klinës, më date 09.03.2023 mori këtë;

V E N D I M

Për formimin e komisionit vlerësues të aplikacioneve nga OJQ-të për financim publik

- I. **Formohet** komisioni komunal për vlerësimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e përfitueseve sipas Thirrjes Publike të datës 13.02.2023, për financim publik të OJQ-ve.

Komisioni përbëhet nga anëtarët:

1. Rexhë Buqani - Drejtoria për kulturë, rini dhe sport
2. Liridon Haxhaj – Drejtoria për kulturë, rini dhe sport
3. Fetah Elezaj – Drejtoria e financave dhe zhvillimit ekonomik
4. Vlera Morina – OJQ
5. Jetmir Berisha – Shoqëri Civile

- II. **Caktohet** anëtare rezervë **Jeta Krasniqi -Marmullaku** e cila në rast të ndonjë konflikti interesi të anëtarëve të rregullt, do ta zëvendësojë atë në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.
- III. Anëtarët e komisionit do të vlerësojnë aplikacionet në përputhje me dispozitat e rregullores së MF-së - Nr - 04/2017, në bazë të kriterëve të kërkuara në thirrjen publike mbështetur në dispozitat e nenit 10 dhe 11 të rregullores MF - Nr. 04/2017 (kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikantët).
- IV. Ky vendim është i plotëfuqishëm për zbatim në momentin që nënshkruhet nga kryetari i komunës.

Të njoftohen:

- Zyra e kryetarit
- Anëtarët e komisionit
- Zyra e informimit
- Arkivi



Kryetari i Komunës

Z. Zenun Elezaj